


SHTOJCA 1

Formulari i kërkesës për leje mjedisore

Emri i kompanisë	Anik Energy SH.P.K
Lloji i veprimtarisë	Parku Solar Fotovoltaik 5.5 MWp
Emri dhe mbiemri i aplikuesit / Nënshkrimi	Sami Makolli 
Vendi dhe lokacioni	Grackë e vjetër, komuna e Lipjanit
Telefoni , fax, e-mail	+383/44 116 964 info@rikon-ks.com blendi@blendi-ks.com
Kopja e vendimit të pëlqimit mjedisor	PO
Certifikatë përdorimi, ose Leje/ Licencë për ushtrim të veprimtarisë nga organi kompetent	PO
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro)	2,582,250.00 €
Fatura e pagesës se tarifës për Leje Mjedisore	PO
Aplikacionin origjinal të plotësuar për Leje Mjedisore në 1 (pesë) kopje fizike dhe një elektronike (CD).	PO

SHTOJCA 2

Aplikacioni për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për Operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	Anik Energy SH.P.K
	Vendi	Lipjan
	Adresa	Rr. "Ibrahim Rugova" p.n Lipjan
	Nr. i tel./fax	+383/44 116 964
	E-mail	info@rikon-ks.com blendi@blendi-ks.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	811991802 02/12/2022
1.1.3.	Personi kontaktues për mjedis	Blert Gjinolli
	Nr. i tel./fax	+383 44 555 190
	E-mail	Blert.gjinolli@ect-ks.com
1.2. Të dhënat për impiantin		
1.2.1.	Emri i impiantit	"Anik Energy" Parku Solar Fotovoltaik 5.5 MWp
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Rr. "E Nalte" Grackë e Vjetër
1.2.3.	Informatat për mjedisin-ndikimet nga kryerja e aktiviteteve	Këto ndikime janë të paraqitura në pikat, 4.1, 5.3, 6.2 dhe 7.1 të Aplikacionit për dhënien e Lejes Mjedisore
2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT		
2.1.	Të dhënat për lokacioni ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Parku Solar Fotovoltaik 5.5 MW në Lipjan ndodhet në zonën kadastrale Grackë e Vjetër, i vendosur saktësisht në koordinatat 42°29'44.30" V dhe 21°5'9.34" L. Lokacioni përfshinë një sipërfaqe prej 10.49 hektarësh në parcelën kadastrale P-71409080-00414-0.



Figura 1.Parcela në zonën kadastrale Grackë e Vjetër.



Figura 2. Harta e vendodhjes së projektit

2.2	Numri kadastral i parcelës	Parcela P-71409080-00414-0
2.3	Përshkrimi i lokacionit dhe të gjitha objekteve	Lokacioni është përzgjedhur duke marrë parasysh potencialin e favorshëm të rrezatimit diellor, disponueshmërinë e sipërfaqes

	aktivitetet e tyre në atë zonë.	për zhvillimin e projektit, afërsinë me infrastrukturën e transmetimit të energjisë elektrike dhe aspektet mjedisore të vlerësuara gjatë fazës së planifikimit të projektit. Në lokacionin ku janë ndërtuar panelet solare, afër projektit gjendet Nënstacioni 110/35/10 "Lipjani". Sipas Informacionit nga Harta Zonale e Komunës së Lipjanit, parcela është e destinuar si zonë bujqësore, ndërsa sipas certifikatës kadastrale shfrytëzimi aktual i tokës është tokë bujqësore e klasës V.
2.4	Të dhënat lidhur me florën dhe faunën në atë lokacion	Zona e projektit bën pjesë në territorin e Komunës së Lipjanit, e cila karakterizohet nga biodiversiteti i pasur dhe kushte të favorshme për zhvillimin e florës dhe faunës. Fitodiversiteti përfaqësohet nga pyje gjetherënëse në zonat më të larta, livadhe, sipërfaqe bujqësore dhe vegjetacion karakteristik përgjatë rrugëve, vendbanimeve dhe parcelave bujqësore. Ndërkaq, zoodiversiteti përfshin një larmi specimesh të gjitarëve dhe shpendëve, të cilat janë karakteristike për këtë rajon. Në vendin e punimeve dhe në zonë në përgjithësi, nuk ka të dhëna për ndonjë lloj të rrallë, apo të pazakonshëm të florës apo faunës.
2.1.4.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Lokacioni ku është ndërtuar Parku Solar Fotovoltaik 5.5MW nga kompania "Anik Energy" në Lipjan, nuk është e ndërtuar në zonë të veçantë të mbrojtur.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore

3.1.1.	Skema e procesit teknologjik	Skema teknologjike në shtojcën 1 të Aplikacionit
3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Parku fotovoltaik në Grackë të Vjetër, Komuna e Lipjanit, është projektuar për prodhimin e energjisë elektrike nga rrezatimi diellor. Sistemi përbëhet nga 8870 module fotovoltaike monokristaline Trina Solar me fuqi nominale 620 Wp , të vendosura mbi konstruksione metalike mbajtëse. Modulet fotovoltaike shndërrojnë energjinë e rrezatimit diellor në energji elektrike në formën e rrymës së vazhdueshme (DC). Energjia elektrike e prodhuar transmetohet përmes kablllove DC të 15 inverterët Sungrow SG350HX , të cilët kryejnë konvertimin e saj nga rrymë e vazhdueshme (DC) në rrymë

		alternative (AC), të përshtatshme për transmetim në rrjetin elektroenergjetik. Inverterët janë të pajisur me teknologji MPPT për optimizimin e prodhimit të energjisë, sisteme mbrojtëse dhe monitorim të vazhdueshëm të performancës. Pas konvertimit, energjia elektrike përcillet drejt transformatorëve, ku tensioni përshtatet sipas kërkesave të rrjetit elektroenergjetik. Më pas, energjia transmetohet përmes kablllove nëntokësore deri në pikën e kyçjes në rrjet, në përputhje me kushtet teknike të operatorit të sistemit. Funkcioni i parkut fotovoltaik monitorohet dhe kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme përmes sistemit SCADA, i cili mundëson mbikëqyrjen e parametrave të funksionimit, evidentimin e parregullsive dhe optimizimin e prodhimit të energjisë elektrike. Procesi teknologjik i parkut fotovoltaik zhvillohet në fazat e mëposhtme: • Absorbimi i rrezatimit diellor nga modulet fotovoltaike dhe prodhimi i energjisë elektrike në formën e rrymës së vazhdueshme (DC). • Transmetimi i energjisë elektrike nga modulet fotovoltaike te inverterët përmes kablllove DC. • Konvertimi i energjisë elektrike nga rrymë e vazhdueshme (DC) në rrymë alternative (AC) përmes inverterëve Sungrow SG350HX. • Transformimi i tensionit përmes transformatorëve për përshtatje me kërkesat e rrjetit elektroenergjetik. • Monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i funksionimit të sistemit përmes sistemit SCADA. • Transmetimi i energjisë elektrike përmes kablllove nëntokësore dhe kyçja në nënstacionin 110/35/10 kV "Lipjani", për injektim në rrjetin elektroenergjetik. Panelet Fotovoltaike Në këtë projekt janë përzgjedhur module fotovoltaike monokristaline Trina Solar TSM-NEG19RC.20, me fuqi nominale 620 Wp, të cilat karakterizohen nga efikasiteti i lartë, besueshmëri në funksionim dhe performancë e qëndrueshme në kushte të ndryshme klimatike. Teknologjia monokristaline mundëson shfrytëzim më efikas të rrezatimit diellor, duke siguruar prodhim të qëndrueshëm të energjisë elektrike gjatë gjithë periudhës së operimit të centralit.
--	--	---

Panelet janë të projektuara për instalime në sisteme fotovoltaike të shkallës së gjerë dhe ofrojnë rezistencë të lartë ndaj ndikimeve atmosferike, ndryshimeve të temperaturës dhe ngarkesave mekanike. Konstrukti i tyre me xham të përforcuar dhe kornizë alumini siguron qëndrueshmëri afatgjatë dhe mirëmbajtje minimale gjatë shfrytëzimit.

Specifikimet kryesore teknike të moduleve fotovoltaike janë:

- Lloji i qelizave: Monokristaline.
- Numri i qelizave: 132 qeliza.
- Fuqia nominale: 620 Wp.
- Dimensionet e modulit: $2384 \times 1303 \times 33$ mm.
- Pesha: 38.3 kg.
- Xhami: Xham 2.0 mm me transmetim të lartë dhe shtresë antirefleksive (AR).
- Materiali kapsulues: EVA.
- Fleta e pasme: Bardhë.
- Korniza: Aliazh alumini i anodizuar.
- Kutia e lidhjes (J-Box): IP68.
- Kabllot: Kabllo fotovoltaike 4.0 mm^2 .
- Lidhëset: MC4 EV02 / TS4 PLUS




Figura 3. Prerja tërthore e panelit

Panelet fotovoltaike kanë të inkuorporuar diodat anashkaluese (Bypass diodes) të cilat lidhen paralelisht me panelin në dalje të secilit modul në drejtim të kundërt. Dioda anashkaluese është një komponent e rëndësishëm në modulet fotovoltaike të cilat parandalojnë në mënyrë efektive djegien e modulit të shkaktuar nga nxehtësia si dhe ruan eficiencën e panelit fotovoltaiik duke marrë parasysh që reduktimin e humbjeve për shkak të hijezimit.




Figura 4. Konfigurimi i Bypass diodës në panelin fotovoltaiik

Konstruksioni

Panelet fotovoltaike janë montuar mbi konstruksione metalike mbajtëse, të projektuara për të siguruar stabilitet, qëndrueshmëri dhe funksionim afatgjatë të sistemit fotovoltaiik. Konstruksioni është projektuar për t'i përballuar ngarkesat nga era, bora dhe ndikimet e tjera atmosferike, në përputhje me standardet teknike përkatëse. Elementet e konstruksionit janë të prodhuara nga materiale rezistente ndaj korrozionit, kryesisht çelik i galvanizuar dhe aliazh alumini, duke garantuar jetëgjatësi dhe nevoja minimale për mirëmbajtje. Sistemi i montimit siguron fiksimin e sigurt të moduleve fotovoltaike, si dhe orientimin dhe pjerrësinë optimale për shfrytëzimin maksimal të rrezatimit diellor.




Figura 5. Konstruksioni

Inverterët

Inverterët janë komponentë kyç të sistemit fotovoltaik, të cilët realizojnë konvertimin e energjisë elektrike të prodhuar nga modulet fotovoltaike nga rrymë e vazhdueshme (DC) në rrymë alternative (AC), duke e bërë atë të përshtatshme për transmetim dhe injektim në rrjetin elektroenergetik.

Në këtë projekt janë instaluar **15 inverterë të tipit Sungrow SG350HX**, të cilët karakterizohen nga efikasitet i lartë, besueshmëri në funksionim dhe sisteme të avancuara monitorimi dhe mbrojtjeje. Inverterët janë të pajisur me teknologjinë **multi-MPPT**, e cila mundëson optimizimin e prodhimit të energjisë në kushte të ndryshme të rrezatimit diellor, duke rritur performancën e përgjithshme të sistemit. Karakteristikat kryesore teknike të inverterit **Sungrow SG350HX** janë:

- **Modeli:** SG350HX.
- **Tensioni maksimal hyrës (DC):** 1500 V.
- **Tensioni nominal hyrës (DC):** 1080 V.
- **Gama e tensionit MPPT:** 500–1500 V.
- **Numri i MPPT-ve:** 12 (opsionale 14 ose 16).
- **Fuqia nominale dalëse (AC):** 352 kVA (në 30°C).
- **Rryma maksimale dalëse:** 254 A.
- **Tensioni nominal (AC):** 800 V.
- **Frekuenca e rrjetit:** 50/60 Hz.
- **Efikasiteti maksimal:** 99.01%.
- **Efikasiteti evropian:** 98.8%.

- **Shkalla e mbrojtjes:** IP66.
- **Temperatura e punës:** -30°C deri +60°C.




Figura 6. Inverteri Sungrow SG350HX

Inverterët janë të pajisur me funksione të avancuara mbrojtëse, duke përfshirë mbrojtjen nga lidhja e kundërt në anën DC, mbrojtjen nga qarku i shkurtër, monitorimin e rrjetit, monitorimin e izolimit, mbrojtjen nga mbitensioni dhe monitorimin e vazhdueshëm të performancës së sistemit. Përveç kësaj, ata mbështesin komunikimin përmes **RS485** dhe **PLC**, duke mundësuar integrimin me sistemin SCADA për monitorim dhe menaxhim në kohë reale të centralit fotovoltaik.

Nënstacioni dhe linja e transmetimit

Parku solar do të furnizohet nga Nënstacioni i Lipjanit me anë të kabllor nentokësor, shtrirja e kabllor do të bëhet përmes kanaleve kabllorike dhe puseta.

Kanalet kabllorike të cilat do të përdoren janë:

- Kanali K-3
- Kanali K-4
- Kanali K-5
- Kanali K-6

Kanali kabllorik K-3 do të shtrihet përgjatë skajit të rrugës nacionale M25 dhe rrugës rajonale R208 në një gjatësi prej 2459 metrash.

Kanali kabllovik K-4 do të shtrihet në pjesën nga nënstacioni deri tek rruga magjistrale e cila shtrihet në një distancë prej 69m.

Kanali K-5 dhe K-6 shtrihen përgjatë rrugës së komunës.

Transformatorët të cilët do të shfrytëzohen janë transformator 10(20)/0.4kV me kapacitet 1600kVA. Bazuar në kapaciteti e instaluar të sistemit fotovoltaiik (5.5MW) është paraparë katër transformator me kapacitet 1600kVA në mënyrë që sistemi të jetë kompatibil dhe të ketë shpërndarje të fuqisë proporcionalisht. Kycja e sistemit fotovoltaiik do të jetë në nivelin e mesëm të tensionit më konkretisht në nivelin 10kV dhe duke marrë parasysh që pjesa AC e inverterit gjeneron tension në vlerë 400V (0.4kV) atëherë transformatori është i tipit ngritës në mënyrë që të të sigurohet niveli i përshtatshëm i tensionit për furnizim.

Transformatorët do të ketë konfigurim DYN5 e cila është lidhje e përshtatshme për sistemin, ku secila fazë ka një ndryshim fazor prej 150° mes tyre.

Transformatori i cili do të shfrytëzohet është transformator 10(20)/0.4kV 1600kVA.




Figura 7.Pamja 3D e transformatorit 10(20)/0.4kV-1600 kVA

Përzgjedhja e komponentëve përcjellëse të trafostacionit është bazuar në pëlqimin elektroenergjetik të lëshuar nga Operatori i Sistemit Shpërndarës (KEDS).

Kthinat të cilat do të shfrytëzohen në trafostacion do të jenë RMU (Ring Main Unit) dhe do të përbëhen nga pesë kthina.

Kthinat në trafostacion do të përbëhet nga:

- Ndarësi i fuqisë
- Ndërprerësi i fuqisë
- Transformatori matës rrymor
- Transformatori matës i tensionit




Figura 8.Kthina transformatorike




Figura 9.Kthina hyrëse/dalëse

Ndërprerësi i fuqisë i cili do të shfrytëzohet është i tipit 20kV, 630A, 16kA, ku në figurë në vijim është paraqitur vizualisht:



Figura 10.Ndërprerësi i fuqisë

3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	8 orë në ditë. 5 deri në 6 ditë pune në javë.
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditorë, mujor, vjetor	Bazuar në simulimin e realizuar në programin PVsyst , centrali fotovoltaik është projektuar të prodhojë gjithsej 8,586,833 kWh/vit energji elektrike, e cila do të injektohet në rrjetin elektroenergjetik. Prodhimi mesatar mujor i energjisë elektrike është 715,569 kWh , ndërsa prodhimi ditor ndryshon në varësi të kushteve klimatike, intensitetit të rrezatimit diellor dhe stinëve të vitit. Prodhimi më i lartë pritët gjatë muajve të verës, veçanërisht në muajt korrik, gusht dhe shtator, kur intensiteti i rrezatimit diellor është më i lartë. Në momentin e hartimit të këtij aplikacioni, projekti ndodhet në fazën përfundimtare të realizimit dhe ende nuk është vënë në operim, prandaj nuk ka të dhëna mbi prodhimin real (të realizuar) të energjisë elektrike. Pas përfundimit të testimeve, energjizimit dhe lidhjes me rrjetin elektroenergjetik, prodhimi real do të monitorohet dhe do të krahasohet me vlerat e projektuara të simulimit PVsyst.
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse.	Faza e ndërtimit: Komponentët hyrës gjatë aktiviteteve që janë zhvilluar në kompaninë “Anik Energy”, për parkun fotovoltaik 5.5 MW do të jenë: • Karburantet djegëse të lëngëta (naftë dhe benzinë), të cilat do të përdoren për furnizimin e automjeteve dhe makinerive të angazhuara në punimet ndërtimore. • Energjia elektrike, e cila do të përdoret për nevojat e kantierit gjatë realizimit të punimeve. • Uji, i cili do të shfrytëzohet për nevoja sanitare të personelit të angazhuar në kantier, si dhe sipas nevojës për pastrimin e paneleve fotovoltaike pas instalimit. Faza e operimit: Gjatë fazës së operimit nuk parashihet konsum i lëndëve të para dhe lëndëve ndihmëse për procesin e prodhimit të energjisë elektrike, pasi energjia do të prodhohet nga rrezatimi diellor përmes paneleve fotovoltaike. Funksionimi i parkut fotovoltaik do të monitorohet dhe menaxhohet përmes sistemit SCADA, ndërsa energjia elektrike e nevojshme për vetë-konsum do të sigurohet nga vetë sistemi fotovoltaik.

		Gjatë mirëmbajtjes periodike mund të përdoren sasi të kufizuara uji dhe materiale ndihmëse, sipas nevojës.
3.1.6.	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre	Kompania nuk posedon rezervuar për deponimin e lëndëve djegëse.
3.1.7.	Lista e legjislacionit dhe udhëzimeve administrative në fuqi	Për plotësimin e formularit për Leje Mjedisore për kompaninë "Elektroheta" është bazuar në ligjet dhe udhëzimet administrative të listuara më poshtë. <u>Ligjet</u> • Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025; • Ligji për Mbeturina Nr. 08/L-071; • Ligji për Ndërtimin Nr. 04/L-110; • Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102; • Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri Nr. 02/L-41; • Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233; • Ligji për Mbrojtjen e Ajrit Nr. 08/L-025; • Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181; • Ligji për Trashëgiminë Kulturore Nr. 02/L-088; • Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174; • Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26; • Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 <u>Udhëzimet Administrative</u> • Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Lejet Mjedisore, i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 • UA Nr. 02/2011 për Normat e Cilësisë së Ajrit; • Udhëzimi administrativ- nr. 13/2013 Për katalogun Shtetëror të mbeturinave.

3.2 Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së mjedisit	Operatori është i përkushtuar për zbatimin e një sistemi të menaxhimit të mbrojtjes së mjedisit, në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi, kushtet e Pëlqimit Mjedisor dhe masat e përcaktuara në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
3.2.2.	Raportimi	Kompania ka realizuar monitorim dhe raportim të vazhdueshëm gjatë fazës së ndërtimit të parkut fotovoltai, k

		përmes vizitave periodike në terren dhe hartimit të raporteve teknike mbi progresin e punimeve. Më 20.05.2026 është realizuar një vizitë teknike në terren, gjatë së cilës është konstatuar se punimet kanë avancuar sipas planit, me përfundimin e fazës së kunjimit dhe të elementeve kryesore të strukturës mbajtëse, ndërsa rreth 50% e moduleve fotovoltaike ishin instaluar. Gjithashtu, ishte përfunduar liferimi i të gjitha paneleve në vendpunishte Më 05.06.2026 është kryer vizita e radhës në terren, ku është evidentuar se rreth 90% e moduleve fotovoltaike ishin instaluar. Gjatë kësaj periudhe kishin filluar edhe punimet për lidhjen e stringjeve të paneleve, si dhe procesi i pastrimit të vendpunishtes nga materialet dhe ambalazhet e mbetura nga montimi. Më 22.07.2026 është realizuar vizita e fundit e monitorimit, gjatë së cilës është konstatuar se instalimi i 15 inverterëve Sungrow SG350HX kishte përfunduar, ishin shtrirë plotësisht kabllot AC dhe DC, ndërsa lidhjet AC ishin përfunduar në të gjithë inverterët. Në këtë fazë projekti ndodhej në përfundim të instalimeve elektrike, me punimet e mbetura të lidhjeve DC, testeve, komisionimit dhe procedurave për lidhjen me rrjetin elektroenergjetik.
4. AJRI		
4.1.	Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse	Në fazën e ndërtimit: • Emetimi i materieve të ndotura në ajër nga automjetet dhe mekanizmat ndërtimor • Pluhuri i cili ngritet gjatë punëve ndërtimore, pastrimeve, hapjen e kanaleve, shtruarjet me dhe, të platove, rrugëve etj, • Lëvizja e automjeteve dhe mekanizmave gjatë punës. Në fazën e operimit: Nuk do të ketë emisione të materieve ndotëse pasi që do të ketë gjenerim të energjisë nga panelet solare.
4.2	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Faza e ndërtimit: Në fazën e ndërtimit, ndryshimi i cilësisë së ajër ka ardhur si pasojë e emetimit të materieve të ndotura në ajër nga automjetet dhe mekanizmat ndërtimor që sipas ligjit për mbrojtjen e ajrit Nr. 08/L-025 konsiderohen si burime lëvizëse të emisioneve në ajër, por duke qenë se të gjitha automjetet,

		kanë përdorur karburante nga kompani të licencuara e gjithashtu automjetet në punishte kanë qenë të mirëmbajtura. Në hapësirat për rreth lokacionit si ndikim në cilësinë e ajrit ka ardhur nga pluhuri i cili është gjeneruar gjatë punëve ndërtimore, pastrimeve, hapjen e kanaleve për shtrirjen e kablllove, shtruarjet me dhe, rrugëve etj, lëvizja e automjeteve dhe mekanizmave gjatë punës. Emetimet e pluhurit gjatë fazës së ndërtimit kanë ndryshuar nga dita në ditë, në varësi të intensitetit dhe llojit të punës që janë zhvilluar. Ndikimet e emisioneve të pluhurit kanë qenë të kufizuara dhe vlerësohen pa pasoja afatgjate në kualitetin e ajrit. Për të minimizuar emetimet e pluhurit, rrugët janë spërkatur vazhdimisht me ujë.
4.3	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Për shkak të natyrës së punëve dhe burimit natyror të energjisë diellore, si dhe për shkak të mos përdorimit të materieve të rrezikshme e rrjedhimisht as depozitimit të tyre nuk ka ndonjë mundësi të ardhjes deri te ndotja e burimeve difuzive.
4.4	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Parku Solar Fotovoltaik 5.5MW nga kompania "Anik Energy" në Lipjan , nuk ka pajisje për trajtimin e gazrave shkarkuese pasi që gjatë funksionimit të vazhdueshëm të impiantit nuk kemi emetim të gazrave shkarkuese nga procesi teknologjik i përfitimit nga burim i energjisë natyrore diellore.
4.5	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajri	Nga aktiviteti i gjenerimit të energjisë natyrore diellore nga "Parku Solar Fotovoltaik 5.5MW" nuk ka emisione të gazrave apo përqendrime të tyre. Megjithatë gjatë punës me makina ngarkuese dhe transportuese të gjitha sipërfaqet manipuluese të spërkaten me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta.
4.6	Monitorimi i emisioneve	N/A
4.7	Monitorimi i emisioneve/cilësisë së ajrit	N/A
4.8.	Raportimet	N/A
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Projektit i Parkut Solar është vetvetiu një kontribuues pozitiv ndaj reduktimit të emetimeve të gazrave serrë. Megjithatë gjatë projektit janë ndërmarr masat e mëposhtme për të zvogëluar ndikimet ndaj ndryshimeve klimatike: Gjatë fazës së ndërtimit Janë përdorur pajisje dhe mjete me konsum efikas të karburantit dhe me standarde të larta për emetimin e gazrave serrë, zvogëlimi i lëvizjes së panevojshme të automjeteve,

		përmes planifikimit optimal si dhe menaxhim i kontrolluar i mbeturinave. Ulja e emetimeve të gazrave serrë Prodhimi i energjisë së pastër nga dielli, e zvogëlon ndjeshëm nevojën për energji nga burimet fosile dhe rrjedhimisht redukton CO₂. Burimet e ripërtërishme të energjisë Janë përdorur panele solare fotovoltaike, për furnizim elektrik. Riciklimi dhe ripërdorimi Pas dëmtimit të një paneli solar, mund të bëhet riparimi i saj me një efikasitet të teknologjisë që lejon vetëm njëra kablllo të hiqet pa pasur nevojë i tërë sistemi të fiket. Mund të ripërdoren panelet solare, dhe gjithashtu të riciklohen sipas standardeve ndërkombëtare.
5. Uji		
5.1.	Ujërat e ndotura	Duke u nisur nga arsyeja se panelet solare në përgjithësi nuk shfrytëzojnë ujin për funksionimin e tyre, atëherë nënkuptohet se edhe ky park i energjisë diellore nuk do të gjenerojë ujëra të ndotura. Faza e ndërtimit: - Gjatë ndërtimit të “Centralit Fotovoltaike 3MW” është përgatitur sipërfaqja punuese ku janë të vendosura strukturat mbajtëse metalike, - janë instaluar panelet solare, instalimi i invertorëve, transformatorëve edhe kablllove që do të vendosen në sipërfaqen e tokës. Faza e operimit: - Gjatë fazës së operimit, nuk do të kemi ndërhyrje në përdorim të ujit.
5.1	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Natyra e aktivitetit nuk ka të bëjë me shfrytëzim të ujit prandaj nuk është e aplikueshme
5.2	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Natyra e aktivitetit nuk ka të bëjë me shfrytëzim të ujit prandaj nuk është e aplikueshme
5.3	Ndikimet në ujë	Faza e ndërtimit: Gjatë kësaj faze nuk do kemi ndikim në resurset ujore. Faza e operimit:

		Gjatë fazës së operimit nuk do të ketë ndikime në ujë për shkak të principit të punës së implementimit të paneleve solare.
5.4	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Natyra e aktivitetit nuk ka të bëjë me shfrytëzim të ujit prandaj nuk është e aplikueshme
5.5	Trajtimi i ujërave të ndotura	Gjatë funksionimit të parkut me energji solare "Parku Solar Fotovoltaik 5.5MW " nuk do të gjenerohen ujërat e ndotura andaj edhe nuk do të bëhet trajtim.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	N/A
5.7.	Raportimi	N/A
5.8.	Leje ujore për shfrytëzim të ujit	N/A
5.9.	Leje ujore për shkarkimin e ujërave	N/A
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	N/A
6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Aktivitet e ndërtimit te Sistemit Fotovoltaik mund të gjenerojnë zhurmë dhe dridhje nga funksionimi i automjeteve transportuese dhe mekanizmave ndërtimorë. Zhurma e cila gjenerohet gjatë orarit të punës mund të arrijë deri në 55-65 dB. Duke pasur parasysh se zona e projektit është jashtë qytetit të Lipjanit dhe larg vendbanimeve nuk janë paraparë ndikime të mëdha nga zhurma.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Duke qenë se në afërsi të "Centrali Fotovoltaik 3MW" nuk ka asnjë receptorë të ndjeshëm, investitori nuk e ka paraparë matjen dhe kontrollin e zhurmës, gjithashtu duke u bazuar në matjet dhe modelimet paraprake të prezantuara gjatë aplikimit për parkun solar nuk është e nevojshme matja dhe kontrolli i zhurmës.
6.3.	Raportimet	N/A
7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Gjatë fazës së ndërtimit, ndryshimet në gjeologji dhe topografi janë minimale dhe shkaktohen kryesisht nga gërmimet e kryera në disa zona për instalimin e kanaleve kabllore. Këto gërmime të tubacioneve për kanalet kabllore përfshijnë proceset e gërmimit të tokës, vendosjen e kablllove, rimbushjen e tokës së gërmuar dhe ngjeshjen e saj.

		Mbeturinat Gjatë fazës së ndërtimit të parkut solar, janë krijuar mbeturina jo të rrezikshme nga materialet ndërtimore, ambalazhimet e ndryshme, mbeturinat komunale që kanë ardhur si pasojë e punimeve të zhvilluara dhe pranisë së personelit në punishten ndërtimore. Për të gjitha llojet e mbeturinave që janë krijuar gjatë fazës së ndërtimit të parkut të energjisë solare është vepruar në pajtueshmëri me Ligjin për Mbeturina Nr. 08/L-071 (2022) që do të thotë se mbeturina e llojit të njëjtë janë grumbulluar dhe transportuar në lokacionet e caktuara të komunës së Lipjanit, pra në deponinë regjionale. Plani i menaxhimit të këtyre mbetjeve përfshinë sigurimin e kontejnerëve të mbetjeve, grumbullimin e rregullt dhe asgjësimin e tyre në mënyrë higjienike apo transportimin e tyre dhe deponimi në lokacionet e caktuara për deponimin e mbetjeve në përputhje me normat në fuqi.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Faza e ndërtimit: - Servisimi i automjeteve është bërë jashtë punishtes dhe nga servise të autorizuar - Ndërrimi i vajit të makinave, është bërë në servise të autorizuar dhe jashtë vend-punishtes. - Në punishte gjatë gjithë kohës ka pasur material dhe pajisje profesionale për parandalimin e rrjedhjeve/shpërndarjeve që në raste të derdhjeve të vajrave të ndryshme të reagohet menjëherë për pastrim. - Për nevojat e personelit punues janë vendosur tualete të lidhura me gropë septike. Faza e operimit: - Gjatë fazës së operimit nuk janë paraparë masa të tilla për shkak të natyrës së punës.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Sipas prospekteve nga shumë prodhues të parqeve solare, shfrytëzimi i tyre mund të bëhet (20 deri 25 vite). Pas kësaj periudhe varet nga investitori se a do të vazhdohet me prodhimin e energjisë duke bërë zëvendësimin me panele të reja apo parku solar të largohet. kur duhet të largohet parku solar nevojitet të përgatitet Raporti i VNM-së, përmes të cilit qartë do të definohet ndikimi në mjedis dhe përshkruhen masat e nevojshme që duhet të ndermirren.

		Largimi i paneleve solare duhet të bëhet në mënyrë që të çmontohen të gjitha pajisjet mekanike dhe elektrike dhe varësisht prej gjendjes së tyre të dërgohen për riciklim në qendrat e licencuara për riciklim të metaleve apo të ripërdoren, kabllo të elektrike do të nxirren nga toka dhe pastaj do të bahet rrafshimi i hapësirave të degraduara dhe bahet mbjellja me barë apo kulturë tjetër varësisht nga gjendja në teren. Rikultivimi i tokës do të bëhet duke ju përshtatur gjendjes së mjedisit rrethues. Gjatë largimit të paneleve solare duhet të merren të gjitha masat për mbrojtjen nga ndikimet negative në mjedis të cilat janë marr gjatë ndërtimit të parkut solar.
8. MENAXHIMI I MBETURINAVE		
8.1	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimit sipas Katalogut Shtetëror të mbeturinave	Mbeturinat të cilat gjenerohen gjatë aktivitetit të kompanisë, mbeturinë si letra, plastika, mbeturinat komunale deponohen në kontejner dhe pastaj barten me kamionë nga kompanitë të cilat i dërgojnë në deponitë regjionale për trajtim të mbeturinave.
8.2	Përshkrimi i magazinimi apo deponimit të mbeturinave	Gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit, mbeturinat do të grumbullohen dhe magazinohen përkohësisht në vende të përcaktuara brenda lokacionit të projektit, të pajisura me kontejnerë ose enë të përshtatshme, të ndara sipas llojit të mbeturinave. Mbeturinat e rrezikshme dhe ato jo të rrezikshme do të magazinohen veçmas, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Magazinimi i përkohshëm do të kryhet në mënyrë që të parandalohet ndotja e tokës, ujërave dhe mjedisit përreth. Pas grumbullimit, mbeturinat do t'u dorëzohen operatorëve të licencuar për grumbullim, transport, trajtim, riciklim ose asgjësim, në përputhje me Ligjin për Mbeturinat dhe aktet nënligjore në fuqi.
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	N/A
8.4	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër- kontratë me	N/A

	kompaninë me leje përkatëse	
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	N/A
8.6.	Raportimi	N/A
9. RREZIKU NGA AKSIDENTET		
Meqenëse aktiviteti i kompanisë konsiston në prodhimin e energjisë elektrike nga energjia diellore, gjatë procesit të operimit nuk kryhet deponimi apo distribuimi i karburanteve të lëngëta, si rrjedhojë rreziku i ndotjes së mjedisit nga këto aktivitete është minimal. Rreziku i mundshëm për mjedisin mund të paraqitet vetëm në raste aksidentale, si rrjedhojë e derdhjes së pakontrolluar të vajrave ose lubrifikantëve nga automjetet dhe makineritë e angazhuara gjatë fazës së ndërtimit ose gjatë aktiviteteve të mirëmbajtjes së parkut fotovoltaik. Për të minimizuar këtë rrezik, automjetet dhe pajisjet do t'i nënshtrohen kontrollit dhe mirëmbajtjes periodike, ndërsa në rast të ndonjë derdhjeje aksidentale do të ndërmerren menjëherë masat e nevojshme për sanimin e saj. Në rast të paraqitjes së ndonjë zjarri apo situatë tjetër emergjente, operatori do të zbatojë procedurat dhe masat e përcaktuara në Planin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Planin Emergjent. Gjithashtu, lokacioni do të jetë i pajisur me pajisjet e nevojshme për mbrojtje nga zjarri dhe personeli do të veprojë në përputhje me procedurat e përcaktuara për menaxhimin e situatave emergjente.		
9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Kompania është e përkushtuar në zbatimin e masave parandaluese për minimizimin e rrezikut nga aksidentet dhe situatat emergjente gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të parkut fotovoltaik. Për këtë qëllim, do të zbatohen procedura të përcaktuara për identifikimin e rreziqeve, parandalimin e aksidenteve dhe reagimin në raste emergjente. Plani i intervenimit të brendshëm përfshin njoftimin e menjëhershëm të personelit përgjegjës, izolimin e zonës së prekur, ndërprerjen e aktiviteteve që mund të rrisin rrezikun, përdorimin e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe ndërmarrjen e masave për kufizimin e ndikimeve në mjedis dhe sigurinë e punëtorëve. Në rastet kur situata tejkalon kapacitetet e kompanisë, do të aktivizohet plani i intervenimit të jashtëm, përmes njoftimit dhe koordinimit me institucionet kompetente, përfshirë Shërbimin e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policinë e Kosovës, Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe autoritetet e tjera përgjegjëse, sipas natyrës së emergjencës.

9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Kompania nuk përdorë substancave të rrezikshme kimike dhe preparate.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave gjatë funksionimit të parkut solar ku mund të vjen nga ndonjëra pajisje apo panel solar. Duhet të bëhen mirëmbajtje të rregullta të pajisjeve dhe makinerive të parkut solar. Implementimi dhe përditësimi i rregullt i Planit të Gatishmërisë dhe Reagimit në rastet emergjente; Trajnimi dhe edukimi i punëtorëve.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	N/A
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Kompania "Anik-Energy" ka hartuar planin emergjent në kuadër të cilit përfshihet edhe plani për mbrojtjen ndaj zjarrit, të gjitha aktivitetet dhe masat e nevojshme në rast të zjarrit janë të përfshira në këtë plan.

10. MASAT NË RASTET E PUNËS JO STABILE TË IMPIANTIT

10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Në rast të paraqitjes së ndonjë avarie ose keqfunksionimi do të ndërpritet puna me anë të masave të sigurisë (siguresat elektrike)
10.2.	Ndërprerja e punës	Sistemi fotovoltaik është projektuar në mënyrë që panelet të funksionojnë në mënyrë të pavarur përmes konfigurimit të tyre elektrik. Në rast të një avarie ose ndërprerjeje të funksionimit, panelet mund të izoloohen dhe të nxirren jashtë funksionit në mënyrë të kontrolluar, pa ndikuar në sigurinë e pjesës tjetër të sistemit. Monitorimi dhe kontrolli i funksionimit të parkut fotovoltaik realizohet përmes sistemit SCADA, i cili mundëson identifikimin e menjëhershëm të parregullsive dhe ndërhyrjen e sigurt në rast nevojë.

11. Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut

Gjatë funksionimit të vazhdueshëm të "Parkut Solar Fotovoltaik 5.5 MW", ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut është i pa përfillshëm.

Personi përgjegjës për mjedis

Blert Gjinolli

Nënshkrimi



Personi përgjegjës i kompanisë

Sami Makolli

Nënshkrimi

